



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 143, Datë 28.08.2020

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “STAVEC” ME KAPACITET TË INSTALUAR 6000 KW.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/2 Prot, datë 21.08.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 976 Prot, datë 16.07.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k., është shoqëri koncesionare e themeluar si detyrim i kontratës së koncesionit nr. 809 Rep, nr. 140 Kol, datë 17.04.2008 dhe është regjistruar pranë QKB-së në datën 27.06.2008, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit” me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Kontrata nr. 809 Rep, nr. 140 Kol, datë 17.04.2008, “Kontratë koncesioni e formës BOT (Ndërtim – Operim - Transferim) për ndërtimin e hidrocentralit Stavec.”, e lidhur midis METE (sot MIE) dhe koncesionarit “KOKA” sh.p.k, ka një afat 35 vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të saj.
- Referuar Kontratës, nr. 809 Rep, nr. 140 Kol, datë 17.04.2008, HEC “Stavec” ka një kapacitet prej 6000 kW dhe prodhim energjie rreth 25 620 000 kWh.

- Aplikuesi ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar sipas *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, apo dokumentacionit të paraqitur jo në formën e parashikuar nga Rregullorja, që ka të bëjë me:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë
Neni 9, pika 1, gërma “c” (të dhëna për aplikuesin) Plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
Neni 9, pika 2, gërma “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Plotësuar pjesërisht.
- Neni 9, pika 2, gërma “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik. Plotësuar pjesërisht.
- Neni 9, pika 2, gërma “f” (Marrëveshje Koncesioni apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës si dhe ndryshim të këtyre akteve). Plotësuar. Aplikuesi duhet të japë shpjegime në lidhje me afatet e hyrjes në fuqi të Kontratës së koncesionit si dhe statusin e kësaj kontrate apo kontratave shtesë.
- Neni 9, pika 4.1.4, gërma c. Oponenca teknike e projektit – Plotësuar pjesërisht. Në vijim do të kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE edhe Oponencën teknike të hartuar përpara nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit.
- Neni 9, pika 4.1.5, gërma b. Leja e përdorimit të ujit – Pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor”.
- gërma c. Leja Mjedisore – Plotësuar Aplikuesit do t’i kërkohet të japë shpjegime dhe/ose dokumentojë statusin e lejes mjedisore që disponon.

Për gjithë sa më sipër do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, te paraqesë dokumentacionin e munguar, atë shtesë apo shpjegues.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec” me kapacitet të instaluar 6000 kW, për një afat 23 - vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI